



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 406/5 prot.

Tiranë, më 11.10.2023

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 689, datë 24.7.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Ervin Pollozhani
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 26.9.2023, është njoftuar vendimi nr. 689, datë 24.7.2023, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Ervin Pollozhani, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, Komisioneri Publik ushtron ankim ndaj vendimit nr. 689, datë 24.7.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Ervin Pollozhani, ushtron detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë, dhe në zbatim të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Bazuar në nenin Ç, pika 1¹ e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, z. Ervin Pollozhani, ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kriterëve, atë të pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (*në vijim referuar si Komisioni*), në zbatim të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e vlerësimit të hartuara për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, si raportin për vlerësimin e pasurisë nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (*në vijim referuar si ILDKPKI*), raportin e vlerësimit të figurës nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar/Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar² (*në vijim referuar si DSIK*) dhe raportin e vlerësimit profesional nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (*në vijim referuar si KLGJ*), nga të cilat rezulton se:

2.1 *ILDKPKI*, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të “*Aktit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Ervin Pollozhani*”,³ ka referuar se:

- i Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- ii Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- iii Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- iv Nuk ka kryer deklaram të rremë;*
- v Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

2.2 *DSIK*, bazuar në nenin 39, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, me anë të raportit mbi kontrollin e figurës nr. 11797 prot., datë 31.10.2017⁴, ka referuar: “*Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Ervin Pollozhani*”.

2.3 *KLJGJ*, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt rivlerësimi, ka përcjellë pranë Komisionit raportin⁵ për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit, z. Ervin Pollozhani.

3. Komisioni, në përfundim të hetimit administrativ, për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur, ka vlerësuar si vijon:

3.1 ***Për vlerësimin e pasurisë.*** [...] *Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht. Nga hetimi administrativ i kryer dhe shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se subjekti i rivlerësimit, në Deklaratën “Vetting” ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tij, ashtu siç parashikohet në pikën 1, të nenit D, të aneksit të Kushtetutës.*

¹ Rivlerësimi përfshin kontrollin e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale, sipas neneve D, Dh dhe E të këtij aneksi dhe ligjit.

² Pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 10/2023, datë 2.2.2023, “Për informacionin e klasifikuar”, më datë 9.3.2023, i cili ka shfuqizuar ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999, “Për informacionin e klasifikuar ‘Sekret shtetëror’, i ndryshuar, bazuar në nenin 63 të këtij ligji, emërtimi i DSIK-së ka ndryshuar në Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK).

³ Shkresa e ILDKPKI-së me nr. *** prot., datë **.10.2018.

⁴ Deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZH-së nr.***, datë **.6.2022.

⁵ Raport i KLGJ-së nr. *** prot., datë **.11.2021.

Në lidhje me problematikat e konstatuara në vlerësimin e kriterit të pasurisë, trupi gjykues çmon se pasaktësitë në deklaram nuk janë të mjaftueshme që të sjellin aplikimin e pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016. Për më tepër, Komisioni, gjatë hetimit administrativ, konstatoi se në asnjë rast pasaktësitë e konstatuara nuk kanë ndikuar në cenimin e burimit të krijimit të pasurive të subjektit të rivlerësimit. Duke gjykuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, deklaramet e pasakta të konstatuara si më sipër nuk ndikojnë në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit. Komisioni çmon se, për shkak të peshës specifike të vogël të tyre dhe të mungesës së pasojave, pasaktësitë e konstatuara nuk cenojnë figurën e gjyqtarit dhe as besimin e publikut te drejtësia. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Ervin Pollozhani, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të shkronjës “a”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016 [...].

3.2 Për kontrollin e figurës. [...] *Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Ervin Pollozhani, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016 [...].*

3.3 Për vlerësimin e aftësive profesionale. [...] *Si përfundim, në analizë të raportit të hartuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, denoncimeve të depozituara nga publiku, shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si dhe dokumentacionit të administruar në këtë kuadër, Komisioni çmon se në vlerësimin e përgjithshëm nuk janë konstatuar shkelje të përsëritura e të qenësishme të natyrës procedurale, gabime thelbësore dhe serioze apo një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara prej subjektit të rivlerësimit, të tilla që mund të çonin në konstatimin e mungesës së aftësive profesionale. Trupi gjykues vlerëson se, në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale të kërkuar nga ligji nr. 84/2016 [...].*

4. Vendimi i Komisionit. Nisur nga përfundimet e mësipërme, për secilin kriter kontrolli, trupi gjykues i Komisionit, bazuar në pikën 5. të nenit 55. të ligjit nr. 84/2016, referuar në nenin 4, pika 2, nenin 58, pika 1, shkronja “a”, si dhe në nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka vendosur:

- *Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Ervin Pollozhani.*

II. Vlerësimi i Komisionerit Publik

5. Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting). Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisioneri Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim referuar si Kolegji).

6. Në krahasim me kompetencat e njohura Komisionit dhe Kolegjit nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit.

7. Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave.

8. Komisioneri Publik, nga shqyrtimi i vendimit nr. 689, datë 24.7.2023, çmon se ai përmban shkaqe ligjore për t'u paraqitur për shqyrtim, nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit. Për sa më sipër, Komisioneri Publik, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, si dhe në nenin 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, ushtron të drejtën e ankimit ndaj vendimit nr. 689/2023, të Komisionit, në tërësinë e tij.

III. Analiza e shkaqeve të ankimit

III.A. Kontrolli i pasurisë

9. Lidhur me kontrollin e kriterit të pasurisë, referuar nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30-33, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik mban në konsideratë se, gjatë kryerjes së procedurave të rivlerësimit, objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi, sipas nenit 179/b të Kushtetutës, materializohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve të subjektit (“Vetting” dhe ato periodike), ku në çdo rast subjekti i rivlerësimit duhet të deklarojë tërësinë e pasurisë së tij dhe të shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të saj, si dhe ekzistencën e të ardhurave të ligjshme, sipas përkufizimit kushtetues.

10. Interesat privatë dhe pasurorë, të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, janë plotësuar fillimisht në “Deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës”, dorëzuar në ILDKPKI, datë **.3.2006, dhe në vijim në deklaratat periodike vjetore për vitet 2006 - 2016 (këtu e në vijim referuar si DV-20...) dhe në Deklaratën “Vetting” (këtu e në vijim referuar si D-Vett.), dorëzuar në ILDKPKI në datën **.1.2017.

10.1 Bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, znj. ***.**, ka deklaruar në cilësinë e personit të lidhur me subjektin e rivlerësimit, fillimisht në deklaratën e pasurisë të interesave privatë të vitit 2008 (dorëzuar në ILDKPKI në datën **.3.2009), dhe në vijim në deklaratat periodike vjetore dhe në Deklaratën “Vetting”. Nga shqyrtimi dhe krahasimi i deklaratave si më sipër, referuar nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, në funksion të nenit D, të aneksit të Kushtetutës, konstatohet se:

11. Në D-Vett., subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, znj. ***.**, ndër të tjera, kanë deklaruar pasuritë si vijon:

12. Pasuria apartament me sip. 99.7 m², ndodhur në rrugën “*”, Tiranë**

12.1 Në D-Vett., subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Kontratë përfundimtare shitblerje (pasuri e paluajtshme) nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.7.2016, me palë shitëse shoqëria “***” sh.p.k. dhe palë blerëse Ervin Pollozhani dhe ***. Shuma 120,000 euro, e likuiduar tërësisht, ku 108.000 euro janë paguar menjëherë në datën **.9.2014, me lidhjen e kontratës*

nëpërmjet transfertës në llogarinë bankare të shoqërisë “***” sh.p.k., dhe 12,000 euro janë paguar në datën **.3.2016, nga llogaria bankare e bashkëshortes, menjëherë me hartimin e procesverbalit të dorëzimit të apartamentit. **Burimi i krijimit, nga shitja e apartamentit të mëparshëm. Vlera 120.000 euro. Pjesa takuese 50% + 50% me bashkëshorten**⁶.

12.2 Lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie, referuar deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe akteve të administruara në dosje rezulton se si burim krijimi për shlyerjen e çmimit të blerjes së pasurisë objekt vlerësimi kanë shërbyer të ardhurat e përfituara nga shitja e një apartamenti të mëparshëm me sip. 97.5 m². Nga aktet e administruara në dosje rezulton se subjekti dhe personi i lidhur me të kanë pasur në bashkëpronësi këtë pasuri apartament me sip. 97.5 m,² ndodhur në rrugën “****”, Tiranë.

12.3 Në DV-2008, personi i lidhur bashkëshortja e subjektit ka deklaruar: *Kontratë sipërmarrje nr. *** kol., nr. *** rep., datë **.9.2007, me shoqërinë “****” sh.p.k., për apartament me sipërfaqe 117 m². Blerë me të ardhurat nga familja e bashkëshortes, nga aktiviteti i tyre tregtar dhe nga kursimet familjare e personale të punës si Mjeke e Përgjithshme. Vlera 117.000 euro. Pjesa takuese 100%.*

12.4 Në DV-2011, subjekti ka deklaruar: *Kontratë shitblerje për pasuri të paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.1.2012, lidhur midis shoqërisë “****” sh.p.k., si shitës dhe ***.*** dhe Ervin Pollozhani, si blerës (në mbështetje të kontratës së sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.9.2007, të lidhur midis shoqërisë “****” sh.p.k. - sipërmarrës dhe ***.*** - porositës). Vlera 11.700.000 lekë. Pjesa takuese 50%.*

12.5 Në të njëjtën deklaratë. subjekti ka deklaruar: *Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.1.2012, e administratorit të shoqërisë “****” sh.p.k., z. ***.***, për kthim shume lekësh si diferencë midis vlerës së Kontratës së Sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.9.2007, të lidhur midis shoqërisë “****” sh.p.k., – sipërmarrësi dhe ***.*** – porositësi, dhe Kontratës së Shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.1.2012, lidhur midis shoqërisë “****” sh.p.k., – shitësi dhe ***.*** e Ervin Pollozhani – blerësit. Vlera 4,446,000 lekë. Pjesa takuese 50%.*

12.6 Lidhur me mënyrën e fitimit të kësaj pasurie rezulton se:

(i) Personi i lidhur, znj. ***.*** (mbiemri para martese) me Kontratë sipërmarrje me nr. *** kol., datë *** rep., datë **.9.2007, ka porositur nga shoqëria “****” sh.p.k., pasurinë e llojit apartament banimi, me sipërfaqe totale prej 117 m², të ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, kundrejt vlerës 117,000 euro. Referuar kontratës së sipërmarrjes për këtë pasuri, porositësi detyrohet të derdhë ditën e nënshkrimit të saj, shumën prej 115,000 euro, që përfaqëson këstin

⁶ ASHK, me shkresën nr. *** prot., datë **.11.2020, konfirmon se subjekti dhe personi i lidhur kanë në pronësi pasurinë apartament, me sipërfaqe 99.7 m², me nr. pasurie ***. Nga verifikimi dhe analizimi i dokumentacionit të administruar mbi mënyrën e fitimit të kësaj pasurie dhe pagesat e kryera për shlyerjen së çmimit të blerjes rezulton se: (i) Në datën **.9.2014, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, bashkëshortja ***.***, në cilësinë e palës blerëse, kanë nënshkruar kontratën e shitjes (paraprake) me nr. *** rep., nr. *** kol., me shoqërinë “****” sh.p.k., me objekt shitblerjen e pasurisë së llojit apartament banimi, me sipërfaqe të përgjithshme ndërtimi prej 113.32 m², sipërfaqe neto 99.17 m², kundrejt çmimit 120,000 euro; (ii) Në datën **.7.2016, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, në cilësinë e palës blerëse, kanë nënshkruar kontratën përfundimtare të shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.7.2016, me shoqërinë “****” sh.p.k. me objekt shitblerjen e pasurisë objekt vlerësimi, apartamentit me sipërfaqe neto prej 99.7 m², ndodhur në rrugën “****”, Tiranë.

e parë të apartamentit objekt kontrate, ndërsa shuma e mbetur prej 2,000 euro, që përfaqëson këstin e fundit, do të paguhet me marrjen e apartamentit në dorëzim.

(ii) Në datën ****.1.2012, është nënshkruar kontrata e shitblerjes me nr.*** rep., nr.*** kol., për apartamentin e ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, ku në cilësinë e palës blerëse shfaqet subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij. Në kontratë, palët kanë rënë dakord që prona do të shitet kundrejt çmimit 11,700,000 lekë. Blerësit (*subjekti dhe bashkëshortja*) bëhen bashkëpronarë në pjesë të pandara të tij, duke gëzuar të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin prej këtij akti.

(iii) Në të njëjtën datë, përfaqësuesi ligjor i shoqërisë “****” sh.p.k., me deklaratë noteriale nr.*** rep.***., ka deklaruar *se i ka kthyer znj. ***.*** dhe bashkëshortit të saj, z. Ervin Pollozhani*, shumën 4,446,000 lekë, si diferencë e çmimit të kontratës së sipërmarrjes së lidhur midis ***.*** dhe shoqërisë “****” sh.p.k., datë ****.9.2007, me çmimin e paguar realisht, sipas kontratës së shitblerjes së pasurisë së paluajtshme, datë ****.1.2012. Në vijim, deklaroi se kjo shumë është likuiduar plotësisht, me para në dorë, përpara nënshkrimit të kësaj deklaratë, jashtë zyrës noteriale.

(iv) Me kontratë shitje nr. *** rep. dhe nr. ** kol., datë ****.8.2014, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë shitur apartamentin e ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, së bashku me orënditë e tij, kundrejt shumës 130,000 euro.

12.7 Komisioni, gjatë hetimit administrativ⁷, i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime mbi faktin e rezultuar se në kontratën përfundimtare të shitblerjes së këtij apartamenti, paraqitet edhe ai në cilësinë e blerësit, ndërkohë që ka referuar se kjo pasuri është e krijuar nga bashkëshortja para martesë, me burim të ardhurat e familjes së saj. Subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar se: *[...] kjo ka ndodhur thjesht dhe vetëm me dakordësinë e ***. dhe dëshirën e saj që kjo pasuri të ishte pjesë e regjimit pasuror të bashkësisë ligjore, pasi në datën e lidhjes së kontratës së shitblerjes, të dy bashkëshortët jo vetëm që kishin krijuar familjen e tyre (lidhur martesë në dt. ****.7.2008), por ishin trashëguar dhe me një djalë.*

12.8 Bazuar në sa më sipër, Komisioni ka analizuar të ardhurat e deklaruara nga subjekti dhe personi i lidhur si burim krijimi për pasurinë *apartament*, ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, konkretisht: (i) të ardhurat familjare të siguruara nga aktiviteti tregtar i familjes së bashkëshortes filluar prej vitit 1995 (fillimisht regjistruar në emrin e bashkëshortes së tij dhe më pas në emrin e familjarëve të saj); (ii) kursimet e familjes së bashkëshortes; (iii) të ardhurat e përfutur nga bashkëshortja e tij nga puna si përkthyes, si dhe (iv) të ardhurat personale të saj si mjeke e përgjithshme dhe si mjeke promovimi.

12.9 (1) Lidhur me të ardhurat e përfuturara si rezultat i ushtrimit të aktivitetit tregtar nga bashkëshortja dhe familjarët e saj, për periudhën nga viti 1995 e në vijim, bazuar në dokumentacionin e administruar, Komisionit i ka rezultuar se:

⁷ Pyetjet nr. 1/ c), e Pyetësorit nr. 2, të dërguar nga Komisioni gjatë hetimit administrativ.

12.10 Personi i lidhur, *****.***** (Pollozhani) ka zhvilluar aktivitet tregtar si person fizik i regjistruar në organin tatimor, për vitet 1996 – 1997, me xhiro të parashikuar 200.000 lekë, për vitin 1996 dhe 250.000 lekë, për vitin 1997.

i. Në vijim, Komisioni për të evidentuar qarkullimin e mundshëm të realizuar nga subjekti tregtar, person fizik, *****.*****, ka arsyetuar se për një vlerësim alternativ dhe sa më objektiv të të gjithë dokumentacionit dhe rrethanave të përfituara gjatë hetimit administrativ, duke iu referuar kuadrit ligjor të kohës mbi bazën e të cilit rregullohej aktiviteti tregtar i biznesit të vogël, ka konkluduar se qarkullimi i subjektit tregtar, *****.*****, p. f., për vitet 1996 – 1997, ka qenë në total në shumën prej 2.350.000 lekë.

ii. Për vitet në vazhdim, subjekti dhe personi i lidhur kanë deklaruar se pas viteve 1997, për shkak të trazirave të kohës, formalisht janë ndërprerë të gjitha marrëdhëniet institucionale me degën e Tatim-Taksave Tropojë, por se aktiviteti tregtar ka vazhduar, pra nuk është ndërprerë zhvillimi i tij. Më tej, prej tyre, referohet se ky biznes u regjistrua në mars të vitit 2002, në emër të nënës së bashkëshortes, znj. *****.*****.

12.11 Bazuar në dokumentacionin e administruar gjatë hetimit administrativ, Komisionit i ka rezultuar e provuar se nëna e bashkëshortes së subjektit ka ushtruar aktivitet tregtar, si person fizik, për periudhën mars 2002 – mars 2005.

i. Komisioni, në konsideratë të faktit se nga DRT Kukës nuk konfirmon qarkullimin e kryer dhe fitimin neto të realizuar për periudhën e ushtrimit të aktivitetit, ka evidentuar në mënyrë alternative qarkullimin e mundshëm të realizuar nga ky subjekt tregtar. Përkatësisht për periudhën ****3.2002 – **12.2002**, paraprakisht ka vlerësuar se ky subjekt ka realizuar minimalisht qarkullimin në shumën prej 2,000,000 lekë.

ii. Ndërsa për vitet 2003 dhe 2004, rezulton se subjekti tregtar **“***.***”**, person fizik, ka realizuar qarkullimin prej 1,000,000 lekë, për vitin 2003 dhe 750,000 lekë për vitin 2004. Për periudhën ****1.2005 – **3.2005**, nuk duket të jetë depozituar/administruar dokumentacion, i cili të referojë të dhëna për pagesa detyrimesh të taksave vendore, tatim të thjeshtuar mbi fitimin apo për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, që lidhen me subjektin tregtar **“***.***”**, person fizik.

iii. Nga ana tjetër, në kushtet kur DRT Kukës ka konfirmuar se ky subjekt nuk ka detyrime tatimore të papaguara, pra nuk evidentohen detyrime tatimore të papaguara për këtë periudhë të ushtrimit të aktivitetit, Komisioni paraprakisht ka vlerësuar se ka realizuar $\frac{1}{4}$ e qarkullimit mesatar të vlerësuar/evidentuar si të realizuar për vitet 2002 – 2004, në përpjesëtim me periudhën e ushtrimit të aktivitetit për këtë vit (për një periudhë 3-mujore), e konkretisht vlerën prej 312,500 lekë.

12.12 Lidhur me aktivitetin tregtar të ushtruar nga babai i bashkëshortes së subjektit, z. *****.*****, Komisionit i ka rezultuar e provuar se babai i bashkëshortes së subjektit ka ushtruar aktivitet tregtar, si person fizik i regjistruar në organin tatimor, për periudhën mars 2005 – maj 2013. Konkretisht për vitet 2005 dhe 2006 ka rezultuar se ky subjekt ka realizuar një qarkullimin prej 750,000 lekësh për vitin 2005 dhe 1,500,000 lekësh për vitin 2006.

i. Sa i takon vitit 2007, nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje, Komisioni konstaton se nuk evidentohen të dhëna për pagesa të taksave dhe detyrimeve tatimore nga subjekti “****.***”, për vitin 2007. Por, nga ana tjetër, në kushtet kur rezulton e provuar se ky tatimpagues ka ushtruar aktivitetet dhe nuk rezultojnë detyrime të papaguara për këtë periudhë, Komisioni paraprakisht ka vlerësuar se qarkullimi i realizuar për vitin 2007 ka qenë minimalisht në shumën prej 2,000,000 lekë dhe, për periudhën deri para pagesës së kryer për porositjen e apartamentit të ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, ka qenë në shumën prej 1,500,000 lekë (3/4 e shumës prej 2,000,000 lekë).

12.13 Në përfundim, Komisioni, për xhirot nga aktiviteti tregtar të sipërcituara, ka llogaritur një fitim në masën 45% të xhiros. Si rezultat, të ardhurat totale të realizuara nga ushtrimi i aktivitetit tregtar nga familja e bashkëshortes së subjektit, deri në momentin e blerjes së apartamentit në rrugën “****”, janë llogaritur në vlerën 5.463.211 lekë⁸.

12.14 *Lidhur me të ardhurat e përfituara nga bashkëshortja e subjektit nga puna si përkthyesë, të pretenduara si burim krijimi për pasurinë apartament, ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, subjekti ka deklaruar se, në periudhën prill 1999 – shtator 2000, znj. ***.*** ka punuar dhe si përkthyesë pranë misioneve UNHCR dhe HCC, dhe është paguar cash në shumën 1.300 USD në muaj ose 23.400 USD, për të gjithë periudhën.*

12.15 Komisioni, lidhur me këto të ardhura pas analizimit të deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe verifikimit të dokumentacionit të depozituar në mbështetje të tyre, ka konstatuar se nuk provohet me dokumentacion justifikues ligjor përfitimi i të ardhurave nga puna e personit të lidhur si përkthyesë dhe në shërbim të organizatave ndërkombëtare UNHCR dhe të WFP, për vitet e pretenduara.

12.16 *Lidhur me të ardhurat e përfituara nga personi i lidhur si asistente dhe/apo mjeke promocioni, gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar se znj. ***.*** ka punuar si “asistente mjeke promocioni”, në vitet 2002-2005, dhe “mjeke promocioni”, me kontratë në vitet 2005-2006, pranë shoqërisë “****” sh.p.k., dhe ka realizuar të ardhura në total në shumën 1.533.000 lekë⁹.*

12.17 Komisioni, lidhur me këto të ardhura, në përfundim të hetimit administrativ, ndër të tjera, ka konstatuar se nuk provohen plotësisht me dokumentacion justifikues ligjor përfitimi i të ardhurave nga puna e personit të lidhur si asistente apo mjeke promocioni, në shoqërinë “****”.

12.18 Në vijim, Komisioni ka evidentuar të ardhurat e pretenduara dhe ato të verifikuara me dokumentacion justifikues ligjor, bazuar edhe në vlerësimin alternativ të kryer mbi të ardhurat e përfituara si rezultat i ushtrimit të aktivitetit tregtar të familjes *** (ku përfshiheshin edhe të ardhurat e përfituara nga paga e personit të lidhur dhe prindërve të saj, paga si të vetëpunësuar në subjektet tregtare, me statusin e personit fizik, të regjistruar në emër të tyre) dhe të ardhurat e realizuara nga personi i lidhur, si mjeke, nga ku ka rezultuar se totali i të ardhurave të

⁸ Referohuni llogaritjeve të paraqitura në tabelën nr. 1, në vendimin e Komisionit.

⁹ Gjithashtu, subjekti, për periudhën qershor 2007 deri në dhjetor 2007, ka deklaruar se znj. ***.*** ka punuar pranë shoqërisë “**** ***” dhe ka realizuar të ardhura deri në shtator 2007, në shumën 169.770 lekë.

realizuara nga familja ***, për periudhën para pagesës së shumës 115,000 euro, është në vlerën 6.551.353 lekë¹⁰.

12.19 Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni ka konstatuar se duket se familja *** nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të provuara me dokumentacion ligjor, për të justifikuar plotësisht pagesën e kryer nga personi i lidhur në datën **.9.2007, në shumën prej 115,000 euro, për porositjen e apartamentit në rrugën “***”, Tiranë, duke i kaluar subjektit barrën e provës, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

12.20 Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, ka kontestuar të ardhurat e llogaritura nga Komisioni dhe, ndër të tjera, ka deklaruar se gjatë hetimit administrativ ka dhënë të gjitha shpjegimet e kërkuara nga Komisioni, si dhe ka depozituar të gjithë dokumentacionin që kishte arritur të administronte në funksion të këtij procesi¹¹. Subjekti i rivlerësimit i ka qëndruar pretendimit të bërë gjatë hetimit administrativ se nuk mund të ngarkohet me detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e të ardhurave, të cilat kanë shërbyer për shlyerjen e çmimit të blerjes së kësaj pasurie. Pra, *për sa kohë kjo pasuri është porositur e paguar para lidhjes së martesës dhe para fillimit të bashkëjetesës*, si dhe në konsideratë të faktit se nuk ka asnjë lidhje dhe/apo kontribut në blerjen e saj. Gjithashtu, subjekti ka pretenduar se është gjendur në kushtet e pamundësisë objektive për sigurimin e dokumentacionit të plotë ligjor provues, në përputhje me parashikimet e përcaktuara nga neni 32/2 i ligjit nr. 84/2016, për të ardhurat e realizuara nga familja e origjinës së bashkëshortes.

12.21 Komisioni, në përfundim, pasi ka administruar shpjegimet dhe provat e depozituara nga subjekti pas kalimit të barrës së provës, ndër të tjera, ka arsyetuar se: *[...] Pas analizimit në tërësi të provave të administruara në harmoni me deklaratimet e bëra në vazhdimësi nga subjekti dhe personi i lidhur, Komisioni krijoi bindjen se, edhe për periudhën janar 1998 – mars 2002, në njësinë e shërbimit në pronësi të familjes *** është ushtruar aktivitet tregtar dhe, si rrjedhojë, janë përfituar të ardhura nga ky aktivitet. Kështu, rezultoi e provuar se tatimpaguesi “***.***”, person fizik, ka paguar taksat/tarifat vendore pranë Bashkisë Bajram Curri, sot Bashkia Tropojë, nga viti 1996 deri në vitin 2002 ... në mungesë të informacionit dhe dokumentacionit mbi qarkullimin e realizuar, si rrjedhojë e ushtrimit të aktivitetit tregtar për periudhën janar 1998 – mars 2002, në një vlerësim alternativ dhe objektiv, Komisioni vendosi që, për efekt analize, është realizuar qarkullimi vjetor prej 2 milionë lekësh ... duke pranuar për efekt analize si të ardhura neto të realizuara nga aktiviteti tregtar për këtë periudhë shumën 3,825,000 lekë. Si përfundim, Komisioni vendosi që, për efekt analize, do të reflektojë si të ardhura neto të përfituara nga aktiviteti tregtar i familjes *** (përfshirë edhe pagat si të vetëpunësuar), për periudhën 1996 – shtator 2007, shumën prej 9,288,211 lekësh, shumë e cila vlerësohet se është pranuar si e tillë pas një analize tërësisht objektive në përputhje me kuadrin ligjor të kohës dhe duket se përmbush kërkesat e nenit D/3 të aneksit të Kushtetutës[...].*

¹⁰ Referohuni tabelës nr. 2, në f. 26 të vendimit të Komisionit. Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë deklaruar gjithashtu se babai i bashkëshortes, si rrjedhojë e ushtrimit të aktivitetit si i peregjistruar, në fushën e tregtimit të bimëve medicinale, ka realizuar të ardhura. Komisioni, në përfundim të hetimit administrativ, ka konstatuar se nuk provohen me dokumentacion justifikues ligjor përfitimi i të ardhurave nga aktiviteti tregtar i pretenduar i shitjes së bimëve medicinale nga babai i personit të lidhur.

¹¹ Referohuni shpjegimeve të datës 14.7.2023, të depozituara nga subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës.

12.22 Lidhur me të ardhurat e pretenduara si të realizuara nga puna e bashkëshortes së subjektit si përkthyes dhe në shërbim të organizatave ndërkombëtare, në përfundim, Komisioni ka vendosur që, në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, për efekt analize të përfshijë, “me rezervë”, edhe shumën 3,263,000 lekë, me burim krijimi punën e personit të lidhur në organizatat ndërkombëtare. Ndërsa, lidhur me të ardhurat me burim nga puna e bashkëshortes si asistente/mjeke promovoni, në shoqërinë “****” sh.p.k., Komisioni ka vlerësuar se, në kushtet kur rezultoi e provuar me dokumentacion justifikues ligjor marrëdhënia e bashkëshortes së subjektit me shoqërinë “****” sh.p.k., marrëdhënie e cila rezulton se është brenda fushës së veprimtarisë së profesionit të saj, ka çmuar të pranojë, megjithëse me rezervë, dhe të reflektojë në analizën e të ardhurave si të ardhura shtesë nga kjo marrëdhënie, vlerën e të ardhurave të referuar në shkresën e shoqërisë “****” sh.p.k., në total në shumën 1,400,000 lekë.

12.23 Bazuar në arsyetimin e mësipërm, Komisioni ka rillogaritur të ardhurat e familjes *** për periudhën 1996 - shtator 2007, në vlerën 15.204.768 lekë¹².

12.24 Komisioni, në konsideratë të prapësimeve të subjektit të rivlerësimit, ka arsyetuar se: *[...] në vlerësim të situatës faktike çmohet, gjithsesi, se problematikat e konstatuara në vlerësimin e të ardhurave të deklaruara si burim krijimi i kësaj pasurie nuk janë të mjaftueshme për të arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm, për kriterin e kontrollit të pasurisë, sipas përcaktimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, dhe se ato nuk konsiderohen se mund të mjaftojnë si shkaqe objektive e proporcionale të vendosura në procesin e rivlerësimit kalimtar, për të ngarkuar drejtpërdrejt me masë disiplinore subjektin e rivlerësimit. ...Në arritjen e këtij konkluzioni, trupi gjykues është bazuar edhe në aplikimin e parimit të proporcionalitetit, duke vënë në balancë rrethanat e konstatuara të lidhura me pasuri të krijuar para martesë në mungesë të kontributit financiar nga subjekti, si dhe në mosevidentimin e ndonjë të dhëne tjetër për deklaram të rremë, fshehje pasurie, apo që të ardhurat e deklaruara për blerjen e saj të jenë rrjedhojë e ndonjë veprimtarie të kundërligjshme – fakt që mund të cenonte pozitën e tij në këtë proces. Për sa u arsyetua më sipër, ligjshmëria e të ardhurave për pasurinë e krijuar para martesë, analizuar në nivelin e provave dhe rrethanave specifike të rezultuara për këtë subjekt, vlerësohen nga trupi gjykues se nuk cenojnë qëllimin e ligjit që normon procesin e rivlerësimit kalimtar [...].*

12.25 Komisioneri Publik, nën dritën e dispozitave të nenit D, pikat 1 dhe 3, të aneksit të Kushtetutës, dhe neneve 30 dhe 33, pika 5, germa “b” dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, çmon se vlerësimi i kryer nga Komisioni për këtë pasuri është i pabazuar në ligj dhe në prova. Nga analiza e veprimeve juridike të kryera, nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim në rrethanat konkrete, rezulton që shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, nuk janë bindëse dhe nuk arriten të provonin të kundërtën e barrës së provës, lidhur me mbulimin me të ardhura të

¹² Referuar akteve në dosje dhe vendimit të arsyetuar të Komisionit nr. 689, datë 24.7.2023, konstatohet se janë përfshirë në shumën e të ardhurave totale dhe të ardhurat në shumën 133.000 lekë dhe 155.760 lekë, të konfirmuara nga ISSH-ja, si të ardhura të realizuara nga punësimi i personit të lidhur pranë shoqërive “****” dhe “**** ****”.

ligjshme të pasurisë *apartament me sip. 97.5 m²*. Konkluzioni i mësipërm i Komisionerit Publik merr në konsideratë një sërë rrethanash specifike të rezultuara nga hetimi, si vijon:

12.26 Lidhur me periudhën e njohjes me bashkëshorten znj. ***.***, subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të Pyetësorit nr. 4, ka deklaruar: *Me ***.*** njohja është bërë në një festë shoqërie të përbashkët, në fundvitin 2005. Njohja familjare është bërë në mars të vitit 2007.*

12.27 Lidhur me kohën e zyrtarizimit të lidhjes me subjektin, personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar: *[...] prindërit e mi ... pasi kam përfunduar Fakultetin e Mjekësisë dhe jam fejuar, në fillim të vitit 2007, me bashkëshortin tim aktual, më kanë dhuruar pjesën kryesore të të ardhurave, të cilat kanë bërë të mundur blerjen e këtij apartamenti nga ana ime.*

12.28 Referuar kontratës së shitblerjes nr.*** rep. dhe nr. *** kol., datë **.1.2012, si dhe certifikatës për vërtetim pronësie, datë **.8.2014, subjekti i rivlerësimit rezulton bashkëpronar *de jure* (50%), i pasurisë *apartament me sip. 97.5 m²*, ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, fakt i deklaruar edhe nga vetë subjekti, në deklaratën e interesave private periodike vjetore.

12.29 Në deklaratat periodike vjetore për vitet 2010-2013, subjekti ka deklaruar si adresë vendbanimi adresën e gjendjes civile të ndodhur më rrugën “****”, Tiranë. Për më tepër, ky apartament është përdorur vetëm nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij, prej vitit 2010 deri në datën **.8.2014, kur kjo pasuri është tjetërsuar nga subjekti dhe personi i lidhur, me kontratën e shitjes nr. *** rep./ ** kol., datë **.8.2014.

12.30 Në Deklaratën “Vetting”, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë deklaruar bashkëpronësinë në pasurinë *apartament me sip. 99.7 m²*, ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, në vlerën 120.000 euro, me burim të vetëm krijimi të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit të ndodhur në rrugën “****”, Tiranë.

12.31 Në DV-2011, vetë subjekti i rivlerësimit deklaroi pjesë takuese në masën 50% për apartamentin e ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, në vlerën 11.700.000 lekë.

12.32 Po në DV-2011, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura në shumën 4.446.000 lekë, me pjesë takuese 50%, të përfituara nga kthimi i një pjese të pagesës së kryer për apartamentin e ndodhur në rrugën “****”, Tiranë. Pra, duket se shuma e kthyer nga shoqëria “****” sh.p.k. është përfituar vetëm nga subjekti dhe bashkëshortja e tij, dhe jo nga familja e origjinës.

12.33 Nga shuma e mësipërme, subjekti ka investuar 3.000.000 lekë, në një depozitë me afat në Bankën ***, në datën **.5.2012, për të cilën deklaroi pjesë takuese 100%, edhe pse gjatë hetimit administrativ, ka deklaruar se investimi për apartamentin në rrugën “****” është kontribut financiar i familjes ***.

12.34 Sa më sipër, Komisioneri Publik vëren se kontratat ligjore, nga rrjedh fitimi i pronësisë së apartamentit në rrugën “****”, Tiranë, janë nënshkruar vetëm nga subjekti dhe personi i lidhur, duke qenë kështu të vetmit pronarë të ligjshëm të kësaj pasurie, që kanë fituar pronësinë në përputhje me një nga mënyrat e parashikuara nga K. Civil. Në asnjë nga aktet ligjore të administruara nuk rezultojnë si palë kontraktore familjarët e familjes ***. Gjithashtu rezulton

se subjekti i rivlerësimit ka realizuar të ardhura nga kjo pasuri, të cilat në vijim janë burimi kryesor i krijimit të pasurive të deklaruara nga subjekti dhe personi i lidhur me të, në Deklaratën “Vetting”.

12.35 Faktet e mësipërme, lexuar në harmoni me deklaratimet e subjektit dhe personit të lidhur, deklaruar në Deklaratën “Vetting” dhe Deklaratën e interesave privatë periodikë të pasurisë, dhe parashikimet e nenit D, të aneksit të Kushtetutës, dhe të ligjit nr. 84/2016, përcaktojnë detyrimin e subjektit për justifikimin e të ardhurave të ligjshme që kanë shërbyer për blerjen e apartamentit të ndodhur në rrugën “***”, Tiranë.

12.36 Sa i përket të ardhurave që kanë shërbyer si burim krijimi për pasurinë *apartment*, ndodhur në rrugën “***”, Tiranë, Komisioneri Publik vlerëson se, bazuar në nenin D, pikat 1 dhe 3, të aneksit të Kushtetutës, dhe nenit 61, pika 3, të ligjit nr. 84.2016, ato mbesin në nivel deklarativ dhe nuk provohet ligjshmëria e tyre për sa më poshtë arsyetuar:

12.37 *Lidhur me të ardhurat e pretenduara nga aktiviteti tregtar i familjes ***, për periudhën 1998-2002, Komisioneri Publik vlerëson se shuma 3,825,000 lekë nuk duhet përfshirë në mesin e burimeve të ligjshme të familjes ***, pasi, bazuar në aktet e administruara në dosje, rezulton se, për periudhën 1998 - mars 2002, nuk konfirmohet nga organet tatimore ushtrimi i aktivitetit tregtar dhe, si rezultat, nuk konfirmohen të ardhura të realizuara në këtë periudhë. Vetë subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë deklaruar në aktin “Relacion shpjegues” dhe në procesverbalin e ILDKPKI-së, datë **.11.2014, se pas viteve 1997, formalisht, janë ndërprerë marrëdhëniet institucionale me Degën e Tatim-Taksave Tropojë.*

12.38 *Lidhur me të ardhurat e pretenduara si të realizuara nga personi i lidhur nga puna si përkthyes në shërbim të organizatave ndërkombëtare, në shumën 3.263.000 lekë, Komisioneri Publik vlerëson se këto të ardhura nuk duhen përfshirë në mesin e burimeve të ligjshme të familjes ***. Nga aktet e administruara në dosje, rezultoi se, edhe pas kalimit të barrës së provës, subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor për të provuar marrëdhënien e punësimit, realizimin faktit të këtyre të ardhurave dhe as ligjshmërinë e tyre. Për më tepër, gjatë hetimit administrativ, rezultoi të jenë referuar vlera të ndryshme dhe kontradiktore lidhur me të ardhurat e pretenduara, pasi në aktin “Relacion shpjegues”, të depozituar bashkëlidhur Deklaratës “Vetting”, nga personi i lidhur, deklarohen të ardhura në shumën 600 USD/muaj, ndërsa gjatë hetimit administrativ, subjekti pretendon se të ardhurat e realizuara kanë qenë në shumën 1.300 USD/muaj. Lidhur me këto të ardhura, në procesverbalin e ILDKPKI-së, datë **.11.2014, subjekti ka deklaruar se: [...] këto të ardhura nuk kanë qenë asnjëherë të dokumentuara, pasi ajo është paguar cash.*

12.39 *Lidhur me të ardhurat e pretenduara si të realizuara nga personi i lidhur, si asistente/mjeke promocioni, pranë shoqërisë “***”, në shumën 1.400.000 lekë, për periudhën mars 2002 - qershor 2005, Komisioneri Publik vlerëson se këto të ardhura nuk duhen përfshirë në mesin e burimeve të ligjshme të familjes ***, pasi, bazuar në aktet e administruara në dosje të Komisionit, gjatë hetimit administrativ, nuk provohet përfitimi faktik dhe as ligjshmëria e tyre, duke mbetur kështu në nivel deklarativ.*

12.40 Për më tepër dhe pretendimi i subjektit të rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ, se këto të ardhura janë realizuar prej vitit 2002, bie ndesh me deklarin e vetë personit të lidhur në Deklaratën “Vetting” dhe në aktin “Relacion shpjegues”, ku znj. *** ka deklaruar të ardhura si mjeke, duke filluar nga viti 2005. Konkretisht ka deklaruar të ardhura si mjeke promovoni nga shoqëria “****”, në vlerën 133.000 lekë dhe jo në shumën e pretenduar nga subjekti, në total prej 1.533.000 lekë.

12.41 Në përfundim, duke zbritur nga totali i të ardhurave të llogaritura nga Komisioni në vlerën 15.204.768 lekë: (1) të ardhurat nga aktiviteti tregtar i familjes ***, për periudhën 1998 - mars 2002, në vlerën 3,825,000 lekë; (2) të ardhurat e personit të lidhur nga puna si përkthyes në shërbim të organizatave ndërkombëtare, në shumën 3.263.000 lekë; si dhe (3) të ardhurat si asistente/mjeke promovoni pranë shoqërisë “****”, në shumën 1.400.000 lekë, të ardhurat e familjes ***, do të rezultonin në total në vlerën 6.716.768 lekë.

12.42 Në vijim, duke zbritur nga kjo vlerë shpenzimet e jetesës së familjes ***, që vetëm për periudhën janar 2000 – shtator 2007, llogariten në vlerën rreth 5.200.000 lekë¹³, rezulton se mundësia e kursimit e familjes *** do të ishte në vlerën rreth 1.500.000 lekë. Kjo shumë është dukshëm e pamjaftueshme për të mbuluar pagesën e shumës 115.000 euro, të deklaruar si të kryer në shtator të vitit 2007, për blerjen e apartamentit të ndodhur në rrugën “****”, Tiranë.

12.43 Çmobjmë, gjithashtu, të theksojmë se edhe kjo mundësi kursimi, në shumën 1.500.000 lekë, duhet marrë me rezervë, pasi nga arsyetimi i Komisionit, duket se, për periudha të caktuara, të ardhurat nga aktiviteti tregtar i familjes *** janë konsideruar bazuar në një vlerësim alternativ.

12.44 Komisioneri Publik vlerëson se nuk qëndron as pretendimi i subjektit të rivlerësimit, mbi pamundësisë objektive për të siguruar dokumentacion provues, për të treguar ligjshmërinë e të ardhurave të familjes së origjinës së bashkëshortes së tij, sipas nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, pasi subjekti nuk solli ndonjë dokument mbështetës, që të justifikonte ekzistencën e një pamundësie objektive apo të provonte se dokumenti nuk gjendet, është dëmtuar apo zhdukur.

12.45 Në përfundim të sa më sipër analizuar, Komisioneri Publik arrin në konkluzionin se, nga kontrolli lidhur me pasurinë *apartament 99.7 m²*, rruga “****”, Tiranë, subjekti i rivlerësimit rezulton se ka kryer deklarim të pasaktë dhe se ndodhet në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të justifikuar këtë pasuri, në kuptim të nenit D, pikat 1 dhe 3, të aneksit të Kushtetutës, dhe neneve 30 dhe 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

13. Likuiditete cash, në shumën 1,000,000 lekë

13.1 Në D -Vett., subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “(1) Gjendje *cash*, me burim krijimi kursimet familjare të pagave. *Vlera*: 1.000.000 lekë. *Pjesa takuese*: 50% me bashkëshorten.

¹³ Referuar akteve të administruara në dosje të Komisionit, familja *** përbëhet nga 6 anëtarë dhe, bazuar në jurisprudencën tashmë të konsoliduar të Kolegjit, shpenzimet e jetesës për periudhën 2000 - shtator 2007, për një familje me 6 anëtarë, llogariten në vlerën 5.200.000 lekë.

(2) Arredimi i banesës në vlerën 1,000,000 lekë, nga pakësimi në vitin 2016, i gjendjes *cash*, të akumuluar në vite nga kursimet familjare”.

13.2 Komisioni, gjatë hetimit, ka konstatuar se, në Deklaratën e interesave privatë para fillimit të detyrës, të dorëzuar pranë ILDKPKI-së, në datën **.3.2006, në seksionin “Deklarimi i interesave private, Pasuritë e paluajtshme, Pasuritë e luajtshme”, ndër të tjera, subjekti ka deklaruar: “400,000 lekë, të ardhura nga puna si jurist pranë parkut urban të udhëtarëve, Bashkia Tiranë dhe të ardhura nga puna *part time*”. Në DV-të për vitet 2006 – 2015, duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar shtesa ose pakësime të likuiditeteve gjendje *cash*, ndërsa në DV-2016, subjekti ka deklaruar: “Gjendje *cash* shuma 1,000,000 lekë, me burim krijimi kursimet familjare ndër vite të pagave personale dhe të bashkëshortes”.

13.3 Gjatë hetimit administrativ, i pyetur nga Komisioni lidhur me likuiditetet *cash*, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar: [...] *Burimi i krijimit i shumës cash 1,000,000 lekë vjen kryesisht nga diferenca e papërdorur e shumës prej 4,446,000 lekësh, e kthyer me deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. ** kol., datë *.1.2012, ...Për sa më sipër, duke qenë se në deklaratën e vitit 2012 është referuar pakësimi i shumës prej 3,000,000 lekësh, nga shuma totale prej 4,446,000 lekësh (deklaruar si shtesë pasurie që në DPV-në e vitit 2011), në fund të vitit 2012, bashkëshortët Pollozhani dispononin në total gjendjen e likuiditetit cash në shumën prej rreth 1.5 milionë lekë. Kjo gjendje likuiditeti cash, e disponuar në fund të vitit 2012, duke i shtuar edhe disa vlera nga kursimet prej të ardhurave familjare për vitet 2013, 2014, 2015 dhe 2016, ka shërbyer si burim për mbulimin e shpenzimeve shtesë të mobilimit të kryera në vitin 2016, deklaruar në shumën prej rreth 1 milion lekë, si edhe krijimin e gjendjes së likuiditetit cash, në shumën prej 1 milion lekësh, deklaruar si pasuri gjendje cash në Deklaratën Vetting [...].*

13.4 Komisioni, ndër të tjera, ka konstatuar se, në DV-2011, është deklaruar përfitimi i shumës prej 4,446,000 lekë, në seksionin e ndryshimit të pasurive. Nisur nga pasaktësia e evidentuar në deklarinimin e kësaj shumë në DV-2011, si edhe duke vlerësuar logjikën e deklarinimit të subjektit, të pranuar prej tij në shpjegimet e dhëna gjatë hetimit administrativ, në kushtet kur në formularin e vitit 2011 nuk referohet dhe nuk evidentohet disponimi i kësaj shume në sistemin bankar, duket se ajo, të paktën deri në momentin e dorëzimit të deklaratës së vitit 2011, ka qenë e disponuar në gjendje *cash*, nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të. Për sa më sipër, nga shqyrtimi dhe analizimi i deklarimeve të bëra nga subjekti në deklaratat e interesave privatë/periodikë vjetorë, të depozituara ndër vite në ILDKPKI, në harmoni me shpjegimet e dhëna gjatë hetimit administrativ, duket se, në fund të vitit 2012, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë disponuar shumën prej rreth 1.500.000 lekë në gjendje *cash*, me burim të ardhurat e kthyer nga shoqëria ndërtuese “****” sh.p.k., në janar të vitit 2012.

13.5 Komisioni, duke marrë në konsideratë disponimin e shumës *cash* 1.500.000 lekë, nga subjekti dhe personi i lidhur, ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë vetëdeklaruar kursime deri në datën 31.12.2015 dhe kanë realizuar të ardhura për vitin 2016, të cilat duket se mundësojnë plotësisht disponimin e gjendjes së likuiditeteve *cash* në shumën prej 1,000,000 lekë, në momentin e dorëzimit të deklaratës së rivlerësimit kalimtar “Vetting”.

Por, nga ana tjetër, ka konstatuar dhe i ka kaluar subjektit barrën e provës, pasi duket se të ardhurat të cilat kanë shërbyer për krijimin e kësaj shume, kanë si burim edhe fondet e kthyera nga shoqëria ndërtuese “****” sh.p.k., në vitin 2012, të cilat janë pjesë e fondeve të paguara nga personi i lidhur në shtator të vitit 2007, për porositjen e apartamentit, ligjshmëria e të cilave nuk është provuar plotësisht deri në këtë fazë të hetimit.

13.6 Në përfundim, Komisioni, pasi ka administruar shpjegimet e subjektit pas kalimit të barrës së provës, ka arritur në përfundimin se: [...] *subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë vetëdeklaruar kursime të likuiditeteve cash deri në datën 31.12.2015 dhe kanë realizuar të ardhura për vitin 2016, të krijuara nga burime financiare të ligjshme, të cilat rezultojnë se mundësojnë plotësisht krijimin dhe disponimin e gjendjes së likuiditeteve cash në shumën 1,000,000 lekë, në momentin e dorëzimit të deklaratës së rivlerësimit kalimtar Vetting [...].*

13.7 Komisioneri Publik, lidhur me pasurinë *likuiditete cash në shumën 1.000.000 lekë*, çmon se konkluzioni i arritur nga Komisioni nuk gjen referencë në dispozitat kushtetuese e ligjore apo në një vlerësim të drejtë të provave dhe jurisprudencës së konsoliduar të Kolegjit, pasi:

13.8 Sikurse është konstatuar dhe nga Komisioni gjatë hetimit administrativ rezultojnë se, në deklaratat periodike vjetore për vitet 2006-2015, subjekti i rivlerësimit dhe/ose personi i lidhur nuk kanë deklaruar shtesa apo pakësime të likuiditeteve *cash*. Si rezultat, Komisioneri Publik e vlerëson të pabazuar pretendimin e subjektit mbi disponimin e likuiditetit *cash* në shumën 1.500.000 lekë, në fund të vitit 2012, pasi referuar dhe jurisprudencës së Kolegjit mbi trajtimin e likuiditetit *cash*, për sa kohë subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratat periodike vjetore *shtesa dhe pakësime të këtyre likuiditeteve cash*, pretendimet e tij gjatë hetimit administrativ, se ka disponuar likuiditete *cash*, mbeten në nivel deklarativ. Në këto kushte, këto kursime të pretenduara të padeklaruara, nuk mund të kenë shërbyer si burim të ardhurash të ligjshme për mbulimin e shpenzimeve të arredimit dhe krijimit të likuiditeteve *cash*, në shumën 1.000.000 lekë, në fund të vitit 2016.

13.9 Nëse në analizën e treguesve financiare të vitit 2016, nuk përfshihen likuiditete *cash* të pretenduara nga subjekti i rivlerësimit, si të mbartura nga viti 2015, atëherë subjekti i rivlerësimit rezultojnë me pamjaftueshmëri financiare në shumën rreth 1.200.000 lekë, për vitin 2016.

13.10 Sa më sipër, Komisioneri Publik vlerëson se, përveçse këto kursime *cash* nuk janë deklaruar në deklaratat periodike vjetore, që shërbejnë si provë në këtë proces, edhe burimi i pretenduar për to, nga shuma 4.446.000 lekë, për sa arsyetuar gjerësisht më lart në shkaqet e ankimit, nuk mbulohet me burime të ligjshme.

14. Shpenzime mobilimi

14.1 Në D-Vett., lidhur me mobilimin e apartamentit me sip. 99.7 m², ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Arredim i banesës 1.000.000 lekë, nga pakësimi në vitin 2016 i gjendjes cash të akumuluar në vite nga kursimet familjare + 10.000 euro tërhequr në datën **.9.2015, si rezultat i përfundimit të Kontratës së depozitës me afat pranë Bankës ***, datë **.9.2014.*

14.2 Në DV-2015, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: Shpenzime të kryera për arredimin e apartamentit të blerë me kontratën e shitblerjes (paraprake) nr. *** rep. dhe nr. *** kol., datë **.9.2014. Vlera 400.000 lekë, shpenzuar nga kursimet familjare.

14.3 Në DV-2015, personi i lidhur ka deklaruar: Shpenzime të kryera për arredimin e apartamentit të blerë me kontratën e shitblerjes (paraprake) nr. *** rep., nr.*** kol., datë **.9.2014. Vlera 10.336 euro me burim krijimi: (i) diferencën e përfituar nga çmimi i shitjes së apartamentit me kontratën e shitjes nr. *** rep., nr. ** kol., datë **.8.2014 (10.000 euro, tërhequr nga banka në datën **.9.2015), si dhe interesat e përfituara nga depozita bankare.

14.4 Në DV-2016, personi i lidhur ka deklaruar: Arredim i banesës nga pakësimi në vitin 2016 i gjendjes *cash*, të akumuluar në vite nga kursimet familjare. Vlera 1.000.000 lekë.

14.5 Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: shpenzime për arredimin, përkatësisht në shumën 400.000 lekë dhe 10.336 euro në vitin 2015, dhe 1.000.000 lekë në vitin 2016.

14.6 Sa më sipër, Komisioneri Publik konstaton se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë lidhur me shpenzimet e mobilimit, pasi në Deklaratën “Vetting” deklaroi shpenzime mobilimi në vlerën 1.000.000 lekë dhe 10.000 euro, ndërsa në deklaratat periodike vjetore dhe gjatë hetimit administrativ deklarohen shpenzime mobilimi në vlerën 400.000 lekë dhe 10.336 euro në vitin 2015 dhe 1.000.000 lekë në vitin 2016.

14.7 Lidhur me mbulimin me burime të ligjshme të këtyre shpenzimeve, bazuar në deklaramet e subjektit të rivlerësimit, rezulton se shpenzimi në shumën 10.336 euro, në vitin 2015, ka si burim krijimi të ardhurat nga shitja e apartamentit me sip. 95.7 m², në rrugën “***”, Tiranë, ndërsa shpenzimet në shumën 1.000.000 lekë në vitin 2016 kanë si burim krijimi pakësimin e kursimeve *cash*. Sikurse është arsyetuar në mënyrë të detajuar më sipër në këtë ankim rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk provojnë mbulimin me burime të ligjshme të apartamentit me sip. 95.7 m², çka afekton dhe ligjshmërinë e shumës 10.336 euro, deklaruar si burim krijimi për arredimin e vitit 2016. Gjithashtu, sikurse analizuar në këtë ankim, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për kursimet *cash* ndër vite, si rezultat dhe deklaram të pamjaftueshëm lidhur me shpenzimet e mobilimit në shumën 1.000.000 lekë, në vitin 2016.

14.8 Lidhur me shpenzimet e mobilimit të apartamentit me sip. 97.5 m² ndodhur në rrugën “***”, Tiranë, në deklaratat periodike vjetore nuk rezulton të jenë deklaruar shpenzime mobilimi për apartamentin e ndodhur në rrugën “***”, Tiranë.

14.9 Në procesverbalin e ILDKPKI-së, datë **.11.2014, i pyetur lidhur me mobilimin e këtij apartamenti, subjekti ka deklaruar: Mobilimi i apartamentit në tërësi, i cili i është dorëzuar bashkëshortes vetëm në muajin prill të vitit 2010, ka kushtuar afërsisht 1.000.000 lekë, të siguruar nga ndihma që na kanë dhënë familja e bashkëshortes sime dhe familjarët e mi. Ndërsa, në përgjigje të pyetësorit standard, ka deklaruar shpenzime të kryera në periudhën 2008-2010, në total në shumën 586.000 lekë.

14.10 Në përgjigje të Pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit, i pyetur nga Komisioni lidhur me këto mospërputhje të konstatuar, ndër të tjera, ka deklaruar: Shuma totale e mobilimit të apartamentit në rrugën “****” ... është rreth 1.000.000 lekë, shumë kjo me burim si të ardhurat e bashkëshortëve Pollozhani dhe ndihmën që kanë dhënë familjet e tyre.

14.11 Sa më sipër, Komisioneri publik konstaton se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë dhe kontradiktor lidhur me shpenzimet e mobilimit të apartamentit të ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, pasi ka deklaruar vlera dhe burime të ndryshme lidhur me këto shpenzime. Konkretisht, në procesverbalin e ILDKPKI-së, ka deklaruar si burim ndihma të dhëna nga familja e bashkëshortes dhe familja e tij, ndërsa gjatë hetimit administrativ deklararon si burim dhe të ardhurat e bashkëshortëve Pollozhani, duke mbetur kështu e paqartë se cili prej deklarimeve të subjektit paraqet saktë situatën faktike. Referuar deklaratave periodike vjetore për vitet 2008-2010, nuk rezulton që subjekti apo personi i lidhur të kenë deklaruar ndihma/dhurime nga familjarët e tyre.

14.12 Në përfundim të sa më sipër, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm lidhur me shpenzimet e mobilimit për apartamentet në pronësi të tij.

IV. Kërkimi i ankimit

15. Nisur nga parashikimi i nenit 179/b/5 të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se vendimi i Komisionit nuk është në pajtueshmëri të plotë me gjendjen e fakteve dhe provave të administruar në fashikull, për krijimin e bindjes se subjekti i rivlerësimit arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë, në kuptim të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

16. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin ose shkarkimin e subjektit, ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara për këtë qëllim;

17. Bazuar në kërkesat e neneve Ç, D, Dh, E dhe F, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 4 dhe 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016;

18. Kërkojmë që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit dhe, në zbatim të nenit 66, pika 1, germa “b”, të ligjit nr. 84/2016, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 689, datë 24.7.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Ervin Pollozhani.

KOMISIONERI PUBLIK

Irena NINO